



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetarja e Komunës

01nr _____

Dt: 19.12.2014

Kryetarja e Komunës së Gjakovës, në bazë të nenit 11,13 dhe 58.a dhe b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenit 9, 10 dhe 14.a të Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve të Komunës, pas shqyrtimit të kërkesës së Klubit Futbollistik “Vëllaznimi” nga Gjakova për mbështetje financiare për tejkalimin e vështirësive ekonomike dhe kryerjen e obligimeve ndaj futbollistëve dhe stafit të angazhuar në këtë klub, me dt: 19.12.2014 e miraton këtë:

V E N D I M

I. Miratohet kërkesa e Klubit Futbollistik “Vëllaznimi” nga Gjakova nr. 01-400-54313 e dt: 19.12.2014, për mbulimin e një pjese të shpenzimeve për kryerjen e obligimeve ndaj futbollistëve dhe stafit të angazhuar në këtë klub, duke e mbështetur këtë kërkesë me subvencione komunale në vlerë prej 4,000.00€ .

II. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që të realizon procesin e zotimit të mjeteve financiare në vlerë prej 4,000.00€, nga mjetet e subvencioneve të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe bartjen e këtyre mjeteve në xhirollogarinë e KF “Vëllaznimi” nr. 1402000001760582- Banka Ekonomike.

III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

IV. Vendimi iu dërgohet :

- Drejtorisë për Buxhet dhe Financa
- Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim
- KF “Vëllaznimi” , Gjakovë
- Arkivit

Kryetarja e Komunës,

Znj. Mimoza Kusari-Lila